



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Nr. 95/20

Nr. i Sq. / Nr. si -5-

Data: / Datum 28. 05. 2020

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLICA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

RREGULLORE
(KKV) NR.04/2020 NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË, NXËNËS
DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS

Maj, 2020

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "c", në lidhje me nenin 17 pika s të Ligjit Nr.03/l-40 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 41.paragrafi 2, pika "c", të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 maj 2020** miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË, NXËNËS DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

- 1.Me këtë rregullore themelohet baza juridike për ndarjen e bursave për studentë të nivelit beçelor, nxënës të shkollave profesionale dhe shpërblimeve për nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.
- 2.Caktohen kategoritë përfituese dhe rregullohet mënyra e dhënies së bursave dhe shpërblimeve.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Përfitues të bursave janë studentët të nivelit baqelor, të cilët studiojnë brenda vendit në universitete publike e që janë banorë të Komunës së Vushtrrisë.
2. Bursa për nxënës të klasës së dhjetë, drejtimi saldues dhe përpunim i drurit në SHMT "Lutfi Musiqi".
3. Përfitues të shpërblimeve janë: nxënësit e shkollave të mesme të larta, të mesme të ulëta të cilët kanë arritur rezultate të larta në provim të maturës, testin e arritshmërisë, gara, olimpiadanë nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Shpërblimi për nxënës** – nënkupton shpërblimin e dhënë në të holla pa kthim, që Komuna e Vushtrrisë e ndanë për nxënësit e shkollave të mesme të larta, të mesme të ulëta të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe atë, në provim të maturës nxënësi që në nivel shkolla është i pari me rezultate, testin e arritshmërisë dhe atë tri vendet e para në nivel komune, kurse për nxënësit pjesëmarrës në gara, olimpiada në nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar për tri vendet e para.
 - 1.2. **Bursë** - Nënkupton ndihmën e dhënë në të holla pa kthim që Komuna e Vushtrrisë ndanë për studentët e nivelit baqelor që studiojnë në universitete publike brenda vendit dhe për nxënës të

klasës së dhjetë, drejtimi saldues dhe përpunim i drurit të cilët ndjekin mësimin në shkollat e mesme të komunës së Vushtrrisë.

1.3. **DKA** – nënkupton Drejtoria Komunale e Arsimit.

Neni 4

Bursa për studentë dhe nxënës

1. Përfitues të bursave janë studentë të rregullt, jo përsëritës të vitit, të cilët studiojnë në universitete publike në Kosovë, në nivelin beqelor dhe që janë banorë të komunës së Vushtrrisë.
2. Nga e njëjta familje, mund të jetë një përfitues i bursës.
3. Përfitues të bursës mund të jenë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucione tjera të buxhetit të Kosovës.
4. Dhënia e bursës fillon nga viti i dytë i studimeve.
5. Përfitues të bursës për nxënës janë nxënësit e klasës së dhjetë në SHMT “Lutfi Musiqi”, drejtimi saldues dhe përpunim i drurit.
6. Bursa jepet një herë për një vit akademik apo për periudhën 1 tetor – 30 shtator për studentë dhe për një vit shkollor apo për periudhën 1 shtator – 31 gusht.

Neni 5

Shpërblime për nxënës

1. Përfitues të këtij shpërblimi janë nxënësit e mësimit të rregullt, që vijojnë mësimet në shkollat publike të Komunës së Vushtrrisë në nivelin e mesëm të ulët dhe nivelin e mesëm të lartë të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe atë:
 - 1.1. Nxënësi maturantë që në provim të maturës në nivel shkolla është i pari me rezultat.
 - 1.2. Nxënësit që në testin e arritshmërisë renditen në tri vendet e para në nivel komune me rezultat.
 - 1.3. Nxënësit pjesëmarrës në gara, olimpiada në nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar që renditen në tri vendet e para me rezultat.

Neni 6

Planifikimi i mjeteve për bursa

1. Në kuadër të kategorisë ekonomike “Subvencione dhe transefre” Kuvendi i Komunës çdo vit fiskal aprovon buxhetin për:
 - 1.1. Bursa për studentë.
 - 1.2. Bursa për nxënës.
 - 1.3. Shpërblime për nxënës.

Neni 7

Shpallja e konkursit për bursa

1. DKA është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave teknike pasi që kryetari i komunës të ketë nxjerrë vendim për numrin e bursave nëpër drejtime dhe shumën për një bursë, shpall konkurs publik për bursa dhe duhet ta ketë këtë përmbajtje:
2. Datën e fillimit dhe përfundimit të konkursit dhe dokumentet e nevojshme
3. Kriteret për konkurrim në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 8

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

1. Kërkohen këto dokumente të nevojshme për bursa:
 - 1.1. Dëshmi e regjistrimit të klasës.
 - 1.2. Certifikatë e provimeve të dhëna.
 - 1.3. Deklaratë e bashkësisë familjare.
 - 1.4. Dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit të luftës, martirit të luftës, ish të burgosurit politik, është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja me gjendje të rëndë ekonomike-sociale.
 - 1.5. Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara –konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, në lëmin arsimor.

Neni 9

Komisioni për ndarjen e bursave

1. Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit 3 anëtarësh.
2. Kryetari dhe një anëtar i komisionit duhet të jenë zyrtarë nga DKA, ndërsa anëtar i tretë një jurist me përvojë nga administrata e komunës.
3. Komisioni mblidhet me ftesën e kryetarit të komisionit, më së largu 5 ditë nga mbyllja e konkursit.
4. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara me konkurs, eliminohen nga gara.
5. Përzgjedhja e kandidatëve për secilën kategori, bëhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
6. Pas përfundimit të përzgjedhjes, jo më larg se 5 ditë nga dita e mbledhjes, komisioni i publikon rezultatet në tabelën e publikimeve, në Web-faqe të komunës, e shkruan dhe e nënshkruan procesverbalin e punës dhe ia dërgon kryetarit të komunës.
7. Pas kalimit të afatit për ankesa, komisioni i fton përfituesit e bursave dhe nënshkruan kontratë me ta.
8. Kontrata nuk merr obligim punësimin e bursistëve pas mbarimit të shkollimit-studimeve.
9. Kontrata obligon bursistët t'i përgjigjen DKA-së, sa herë që DKA-ja kërkon dokumente që përcjellin nivelin, vijueshmërinë dhe cilësinë e mësimave-studimeve.
10. Komisioni në fjalë e informon Kuvendin e Komunës për tërë procesin e ndarjes së bursave.

Neni 10

Kriteret për përfitimin e bursës

1. Kandidatët vlerësohen me pikë për suksesin e vitit paraprak akademik si në vijim:
2. Studenti me notë mesatare mbi 9-të, vlerësohet me 30 pikë
3. Studenti me notë mesatare mbi 8-të, vlerësohet me 20 pikë.
4. Studenti nga familja e dëshmorit shpërblehet me bursë pasi që ti ketë plotësuar kushtet tjera të parapara me këtë rregullore.
5. Studenti nga familja e të burgosurve politikë, vlerësohet me 5 pikë.
Studenti nga familja me asistencë sociale, vlerësohet me 5 pikë.
6. Studenti nga familja e martirëve, veteranëve dhe invalidëve, vlerësohet me 5 pikë.
7. Studenti, i cili nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 5 pikë.
8. Studenti, që ka marrë mirënjohje apo certifikatë shtetërore, kombëtare apo ndërkombëtare, e që ka arritur rezultate të larta, duke e zënë njërin nga tri vendet e para në ndonjë garë-konkursi në lëmin arsimor, vlerësohet me 25 pikë.
9. Studenti, që ka likuiduar vitin paraprak me afat të rregullt, vlerësohet me 5 pikë.
10. Studenti me nevoja të veçanta nuk u nënshtrohet kriterëve të këtij neni, përveç që duhet ta ketë të regjistruar vitin akademik.
11. Në rastet kur dy kandidatë pas vlerësimit mbledhin pikë të barabarta, atëherë radha e përparësisë është kjo:
 - a) kandidati me notë mesatare më të lartë pas presjes dhjetore;
 - b) për notë mesatare të njëjtë pas presjes dhjetore përparësi i jepet kandidatit që ka aplikuar i pari.
12. Aplikacionet e studentëve, që kanë notë mesatare më pak se 8.00 nuk shqyrtohen.

Neni 11

Procedurat e ankesave

1. Çdo kandidat i pa kënaqur me rezultatin e komisionit për ndarje të bursave, gëzon të drejtën e ankesës tek komisioni i ankesave, brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i komunës nxjerrë vendim për emërimin e komisionit ad-hoc tre anëtarësh, për shqyrtimin e ankesave.
3. Anëtarët e emëruar të komisionit janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë), nga të cilët një jurist, një zyrtar nga DKA-ja dhe i treti po ashtu nga administrata.
4. Nuk mund të jenë anëtar të këtij komisioni, anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në ndarjen e bursave.
5. Vendimi për emërimin e komisionit publikohet në Web-faqe të komunës dhe në tabelë të shpalljeve.
6. Komisioni është autoritet vendimmarrës, përfundimtar i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve.
7. Vendimet në emër të komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit.
8. Çdo veprim shkruhet në 4 kopje në origjinal.
9. Një kopje i dërgohet kryetarit të komunës, një komisionit për ndarje të bursave, një palës që është ankuar dhe një vendim arkivit të komunës.
10. Afati për ankesa është 8 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve për përfitues të bursave.
11. Në vendim jepet edhe arsyetimi.

Neni 12
Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë sipas procedurave për miratimin e akteve normative.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Ndarjen e Bursave dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë, 01 Nr: 86/15, datë 30.04.2015.

Neni 13

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 14

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

